

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË MEMALIAJ

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Memaliaj**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 31.3.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 69, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 111/7, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Lulzim Meçe, Kryetar i Bashkisë Memaliaj, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje Me shkresën nr. 978/8, date 19.12.2012 “Dërgim Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”, KLSH i ka kërkuar, Bashkisë Memaliaj te zbatoj: 19 masa organizative, 7 masa shpërblim dëmi, 12 masa administrative dhe 3 masa disiplinore. Bashkia Memaliaj ka vepruar në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pasi nga 41 rekomandimet të kërkuara ka zbatuar vetëm 24 prej tyre ose 57.9 %. Konkretisht, ka zbatuar: 6 masa organizative, 6 masa shpërblim dëmi dhe 12 masa administrative, si dhe ka në proces zbatimi edhe 2 masa te tjera organizative .

Rekomandim 1. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 978/8, date 19.12.2012 dhe konkretisht:

-Të vazhdojë procedura për identifikimin e subjekteve në QKR dhe DRT Gjirokastrë dhe të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin nga 6 subjekte i shumës 284,200 lekë.

-Zyra e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike dhe të Taksave Vendore të Bashkisë, të arkëtojë detyrimet e prapambetura për 8 subjekte në shumën 3,017,750 lekë.

-Në bashkëpunim me ZVRPP Tepelenë, për përshpejtimin e procesit të regjistrimit të aseteve pronë e Bashkisë nga të ardhurat e vitit 2015, të gjejë fonde dhe të bëhet regjistrimi i aseteve dhe evidentimi i tyre në kontabilitet.

-Zyrës e Financës me Zyrën e Taksave Vendore, të pasqyrojë gjendjen e detyrimeve dhe penalteteve, të bëjë kontabilizimin e tyre dhe paraqitjen në bilancin e vitit 2015 e në vazhdim.

-Nga Zyra e Taksave Vendore, në bashkëpunim me Zyrën e Financës të evidentohet sipërfaqja e tokës bujqësore dhe të ndiqet më përparësi arkëtimi i taksës së tokës.

2. Gjetje. Struktura organizative e Bashkisë, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak është një strukturë jo e plotë dhe pa nivelin profesional të nevojshëm, duke mos siguruar arritjen e objektivave të organizatës, pasi nuk përputhet me funksionet që duhet të kryejë kjo njësi vendore, të përcaktuar në kërkesat e ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” .

Rekomandim: Të ngrihet grup pune për rishikimin e strukturës organizative e Bashkisë sipas kërkesave të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ti kërkohej Këshillit të Bashkisë, miratimi i saj.

3. Gjetje. Mungojnë programe të plota financiare afatmesme (PBA), në kundërshtim me UMF nr. 20/1, datë 26.02.2011, nr. 7/1, datë 29.02.2012 dhe nr.9/1 datë 25.02.2013 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”. Programet buxhetore vjetore janë paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak thjesht, duke përshkruar të dhënat tabelore, pa një analizë të hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë, me një planifikim të pastudiuar dhe të fryrë pa bazë reale të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke e kthyer buxhetin e vitit koherent në buxhet, që pjesën e më të madhe financon borxhet e trashëguara të viteve të mëparshme. Mungojnë raportet periodike të monitorimit në kundërshtim me pikën 254 e 255 të kapitullit

“Raportet e monitorimit” të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” në zbatim të nenit 65 ligjit organik të buxhetit .

Rekomandim. Bashkia Memaliaj të marrë masa për ngritjen e grupit të punës (GMS) dhe të kryejë hartimin e programit zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe atij vjetor të mirë studiuar, hartimin dhe planifikimin e treguesve, të bazuar mbi hartimin më parë të planit strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare, projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

4. Gjetje. Në zbatim të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Gjirokastrë, janë kryer pagesa e detyrimit në favor të ish punonjësës së Bashkisë znj. R.C në vlerën pjesore 100,000 lekë, pa lënë më parë gjurmën e auditimit, sipas Udhëzimit nr. 2 datë 6.02.2012 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” .

Rekomandim. Kryetari i Bashkisë të mos vazhdoj pagesat e detyrimeve ndaj ish punonjësve të larguar nga puna të përcaktuara me vendime gjyqate, pa lënë më parë gjurmët e auditimit për të shpjeguar dhe nxjerr përgjegjësinë e largimeve nga puna të këtyre punonjësve.

5. Gjetje. Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes së shërbimit të pastrim-gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave dhe dekorit, janë kryer pagesa pjesore për detyrimet e viteve të mëparshme në vlerën 6,473,110 lekë. Këto pagesa janë kryer ne baze të 11 faturave tatimore në vlerën 7,531,509 lekë dhe ne baze të situacioneve për shërbimin e kryer për pastrim-gjelbërimin, mirëmbajtjen e varrezave dhe dekorit. Situacionet që justifikojnë shërbimin e kryer janë miratuar nga supervizori, në mungesë të dokumentacionit të plotë, pasi nuk janë ndjekur në mënyrë periodike, mbi bazën e grafikut të shërbimeve për periudhën e situacionuar. Po kështu dhe faturave për shpenzimet e kryera për riparime apo blerje materiale, janë situacionuar në zëra të vecantë punimesh në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar Kreu VIII, pika 1/(d), Pika 2/a,b. “Mbikëqyrja e kontratës” dhe ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 pika 3/a, dh dhe ligjit nr.8094 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” neni 14 .

Rekomandim. Bashkia Memaliaj të marrë masa për kontrollin dhe mbikëqyrjen nga supervizori të llogaritjeve, kontrollin e zbatimit të kontratës dhe pagesat e shërbimit pastrim-gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave dhe dekorit, duke siguruar mbajtjen e një dokumentacioni të plotë, grafikun e shërbimeve dhe faturat të blerjeve për zëra të veçantë punimesh e shërbimesh të situacionuara.

6. Gjetje. Në 35 raste në shumën 2,612,854 lekë të blerjeve të mallra e shërbimeve në vlera të vogla u konstatuan mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumenteve mbështetës justifikuese të pagesave në kundërshtim me rregullat e menaxhimit financiar dhe të prokurimit publik. Këto mangësi dhe parregullsi konsistojnë në: akt-konstatimet apo kërkesat për përcaktimin e nevojave për blerje, në argumentimin e fondit limit, në faturat e blerjeve të cilat nuk janë sipas formatit të thjeshtë tatimor, në fatura të pa plotësuar konform dokumentit të plotë financiar dhe të pa firmosura nga anëtarët e komisionit, si dhe nuk janë mbajtur procesverbale apo akt-marrjet në dorëzim të mallrave .

7. Rekomandim. Bashkia Memaliaj të marrë masa për vendosjen e rregullave për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit mbi bazën e dokumenteve financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohen nga titullari.

8. Gjetje. Në lidhje me pasqyrimin në bilanc të gjendjeve të llogarive u vërejt se, janë kryer veprime kontabël, në kundërshtim me në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Konkretisht: gjendja e llogarive 411-419 “Klientë e llogari të ngjashme” në fund të vitit 2014 në vlerën 30,457,698 lekë është paraqitur e gabuar, pasi kjo vlere përfaqëson detyrimet e konstatuara, që ka Bashkia ndaj të tretëve për tu likuiduar. Po kështu, gjendja pjesore e llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” në vlerën 93,418,188 lekë dhe e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje,

vegla pune” ne vlerën 892.471 lekë, janë të mbartura dhe të trashëguara nga viti 2000, me shkrirjen e Ndërmarrjes Komonale dhe këto llogari janë të pa analizuara dhe pa inventarë analitik (nuk janë mbajtur partitaret analitik).

Rekomandim. Të bëhet sistemimi i gjendjes në kontabilitet të vlerës prej 30,457,698 lekë të llogarisë nr. 411-419 “Klientë e llogari të ngjashme” në llogarinë nr. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” në aktivin e bilancit.

9. Gjetje: Janë kryer pagesa të paparashikuara në buxhetit i miratuar nga Këshilli Bashkiak ne artikulli buxhetor “shpenzimet operative” në vlerën totale 1,213,200 lekë. Kjo vlerë i është paguar: 4 personave për shërbimin e kryer për mirëmbajtjen e ndriçimit te qytetit ne vitin 2013, për shërbimin e ruajtjes se godinës së Bashkisë , për trajner ekipi futbollit në vitet 2013-2014, dhe në 2 raste për mirëmbajtje KUZ në vitin 2013, në bazë të aktmarrëveshjeve të hartuara midis palëve me afat 1- vjeçar. Këto aktmarrëveshje, nuk janë hartuar sipas formatit tip të kontratës së shërbimit të përcaktuar në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 420.

Rekomandim: Për çdo rast, punësimi dhe pagesa e individëve për shërbime të ndryshme të ofruara të bëhet me miratim të Këshillit Bashkiak si dhe në bazë të kontratave tip për shërbime të përcaktuar në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil ne Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

10. Gjetje. Në procedurën e prokurimit, me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Rrapo Çela”, i rrugës hyrëse qytet “Selam Musai”, “Memo Nexhipi”, “Tahir Gashi”, “Raship Brahimi”, në qytetin Memaliaj”, me fond limit në vlerën 32.698.927 lekë pa tvsh, Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk ka nxjerrë urdhrin për ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit si dhe nuk është përpiluar procesverbali për rillogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik .

Rekomandim. Për çdo procedure prokurimi, para kërkesave për punë mallra e shërbime të ngrihen grupe pune për llogaritjen e fondit limit mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

11. Gjetje. U konstatua se, nuk është plotësuar struktura organizative e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka rregullore për krijimin e sektorëve funksional brenda Drejtorisë dhe ndarje të detyrave individuale sipas sektorëve. Punonjësit janë me arsim të mesëm dhe detyrat ndiqen në tërësi si për regjistrimin, vlerësimin, kontrollin në terren dhe arkëtimin e borxhit nga subjektet debitor, gjë që ka sjellë mangësi të theksuara lidhur me ngarkesën dhe ndjekjen e aktivitetit të 185 subjekteve në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar .

Rekomandim. Bashkia Memaliaj, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës së Sektorit të Tatim-Taksave me personelin përkatës të kualifikuar, duke emëruar punonjës me arsim të lartë dhe me eksperiencën e nevojshme përkatëse.

12. Gjetje. Nga auditimi i ushtruar për 100 subjekte tatimpagues për 54 % e tyre, rezultoi se janë hapur dosjet individuale për secilin subjekt, por në çdo dosje mungon inventari për mbajtjen e dokumenteve dhe numrin e fletëve. Dosjet e subjekteve nuk janë të plota, pasi ato përmbajnë vetëm disa dokumente, që kur kanë ardhur nga ish-Dega e Tatim-Taksave Gjyrokastër. Dosjet nuk janë përditësuar dhe nuk janë të plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, pasi në shumicën e dosjeve mungon; Njoftim detyrimi me konfirmimin nga administratori ligjor i subjektit, Njoftim vlerësimi tatimor dhe Dokumenti i Pagesës së detyrimit, (Mandat arkëtimi). Dokumentet e Pagesës së Detyrimeve mbahen në mënyrë të parregullt. Gjithashtu mungojnë deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, gen-planet apo planimetritë përkatëse (për taksën e ndërtesave) dhe në asnjë rast nuk ka procesverbal për verifikimin në terren të sipërfaqeve, ku subjekti ushtron veprimtarinë, të akt-konstatimeve apo akt-verifikimeve, për mbylljen e aktivitetit të konfirmuar nga Policia e Bashkisë, etj.

Rekomandim. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të pergatisë dhe të plotësojë me dokumentacionin e munguar të gjitha dosjet e subjekteve të regjistruara dhe atyre të pa regjistruara. Dosjet të plotësohen dhe të inventarizohen nga specialisti përkatës, duke evidentuar me dokumentet e

pasqyrat përmbledhëse vjetore progresive me të dhënat për detyrimet, arkëtimet, kontrollet, llogaritjet e penaliteteve dhe përcaktimin e statusit të subjektit konform kërkesave ligjore.

13. Gjetje. Në Bashkinë Memaliaj evidentohen 192 biznese, nga të cilat 55 subjekte janë të regjistruara dhe 137 subjekte të pa regjistruara në QKR, për të cilët nga punonjesit e sektorit për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore rezulton se, për asnjë rast nuk është zbatuar neni 17, i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar, mosveprim që ka sjellë si pasojë një mungesë të ardhurash në shumën 2,189,740 lekë në kundërshtim me pikën “a” që parashikon vendosjen e gjobës në masën 25 % të detyrimit për taksën .

Rekomandim. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të kontabilizojë dhe të kërkojë arkëtimin e shumes 2,189,740 lekë në zbatim të pikës “a”, për vendosjen e gjobës subjekteve të paregjistruara në masën 25 % të detyrimit tatimor.

14. Gjetje. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka administruar në dosje deklaratat e xhiros për biznesin e vogël për vitet 2013-2014, si dhe nuk ka mbajtur evidencën e numrit të subjekteve, që nuk kanë paraqitur këtë deklaratë pas datës 1 Mars të çdo viti. Gjithashtu për vitet 2013 dhe 2014 asnjë subjekt nuk ka paraqitur deklaratat dhe për ta nuk është nxjerrë dhe dërguar zyrtarisht njoftim vlerësimi i konfirmuar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit. Mos depozitimi i deklaratave parashikuese të qarkullimit është në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

Rekomandim. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të llogaritë penaltetin dhe t’i shtohet detyrimit të vitit 2015 ndaj subjekteve që nuk kanë deklaruar në afat, duke shkelur ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 113 “ Mos deklarimi në afat”, ku parashikohet se: *“Tatimpaguesi, i cili nuk lëshon deklaratën tatimore në afat dënohet me gjobë me 10,000 lekë për çdo deklaratë tatimore të pa dorëzuar”*.

15. Gjetje. Në vitin 2013 plani i realizimit i të ardhurave është realizuar 15.09 %, ose në vlerë absolute më pak nga plani për shumën 7,560,016 lekë, ndërsa për vitin 2014 të ardhurat janë realizuar 14.4 %, ose në vlerë absolute më pak nga plani për shumën 7,858,418 lekë. Për dy vitet të marra sëbashku është krijuar një e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë në shumën 15,418,434 lekë, duke paraqitur një performancë shumë të ulët të aktivitetit të Bashkisë në fushën e arkëtimit të taksave dhe tarifave .

Rekomandim. Sektori i Taksave dhe Tarifave të marrë masa të përfshijë në detyrimet e borxhit të subjekteve shumën prej **15,148,434 lekë**, të ardhura të pa arkëtuara dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e tyre, të detajuara sipas llojit të taksave dhe sipas pasqyrave bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

16. Gjetje. Bashkia Memaliaj nuk ka filluar puna mbi përgatitjen e dokumentacionit teknik për hartimin e studimeve pjesore urbanistike, masterplaneve të zhvillimit territorial dhe planeve të veprimit, në zbërthim dhe në zbatim të Planit Rregullues, sipas Planimetrisë dhe Rregullores, që i është bashkëlidhur vendimit të miratuar nga KRRTRSH-ja edhe pse nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), nëpërmjet shkresës nr. 497 prot, datë 09.04.2014 është kërkuar hartimi i raportit vjetor të zhvillimit të territorit sipas materialeve ndihmëse, gjendje në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, me VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të zhvillimit të territorit”.

Rekomandim. Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të marrë masa për fillimin e punës për hartimin e studimeve pjesore urbanistike, të masterplanit të zhvillimit territorial, në zbërthim dhe në zbatim të Planit Rregullues sipas Planimetrisë dhe Rregullores, që i është bashkëlidhur vendimit të miratuar nga KRRTRSH-ja.

-Të merren masa nga Kryetari i Bashkisë për miratimin e strukturave të rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit të bashkisë, duke përcaktuar rregullat, standardet, kushtet dhe normat teknike të planifikimit, strukturat e banimit, strukturat e shërbimeve, strukturat mikse.

- Të hartohet rregullorja e planifikimit të territorit të bashkisë duke përcaktuar kushtet dhe normat e zhvillimit si: treguesit e distancave midis strukturave, pemëve dhe rrugëve, lartësitë e strukturave,

koeficienti i shfrytëzimit të tokës për ndërtim, intensiteti i ndërtimit, koeficientët e shfrytëzimit të tokës për rrugë dhe hapësira publike.

- Nga zyra e urbanistikës të rritet numri i kontrolleve mbi cilësinë e punimeve dhe të kërkohej informacione dhe raporte në zbatim të kontratës dy palese të nënshkruar.

17. Gjetje. Zyra e Urbanistikës për vitet 2013 dhe 2014, ka funksionuar pa Këshill Teknik dhe me personel të reduktuar me 1(një) specialist me strukturë jo të plotë sipas ligjit të urbanistikës, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 45/1 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar, por duke ruajtur korrespondencën ligjore me subjektet juridike dhe private duke argumentuar mos dhënien e leje ndërtimi për mungesë të KRRT të Bashkisë, të projekteve dhe dokumentacionit ligjor, dhe në mungesë të planit rregullues urbanistik të aprovuar për qytetin .

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Zyra e Urbanistikës Bashkia Memaliaj, të marrin masa për ngritjen e Këshillit Teknik me specialistë të fushës së urbanistikës, si dhe të plotësojë me personelin e nevojshëm zyrën e urbanistikës në numër dhe me specialistë të fushës së ndërtimit.

18. Gjetje. Nga Njësia e Urbanistikës nuk është krijuar regjistri i planifikimit të territorit, për territorin që administron Bashkia Memaliaj, sipas kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

Rekomandim. Kryetari i Bashkisë, Zyra e Urbanistikës Bashkia Memaliaj, të marrin masa për krijimin e regjistrit të planifikimit të territorit, për sipërfaqen që administron Bashkia Memaliaj.

19. Gjetje. Zyra e Urbanistikës për vitin 2013 sipas akt kontrolleve ka regjistruar 9 ndërtime pa leje dhe pa dokumentacion përkatës tekniko-ligjor, në kundërshtim me ligjin nr.10119/23.04.2009 “Për Urbanistikën” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 58 të Raportit Përfundimtar të Kontrollit*).

Rekomandim. Zyra e Urbanistikës të bashkëpunojë me subjektet fizike që kanë ndërtuar pa leje, për plotësimin e dosjeve me projekte si dhe dokumentacionin tekniko-ligjor sipas ligjit.

20. Gjetje. Në zbatimin e punimeve të tenderit me objekt “Rikonstrukcion i rrugës: “Rrapo Çela”, “Selam Musai”, “Memo Nexhipi”, “Tahir Gashi”, dhe “Raship Brahimi”, dosja e zbatimit dosja rezultoi pa dokumentacion të plotë tekniko-ligjor, ditari i punimeve, certifikatë cilësie për materialet e ndërtimit dhe grafiku i punimeve, foto dhe të tjera .

Rekomandim. Kryetari i Bashkisë të kërkojë nga mbikëqyrësi i punimeve mbikëqyrje korrekte të realizimit të punimeve, me qëllim rritjen e cilësisë mbi përdorimin e materialeve të ndërtimit dhe të shoqërohen me certifikatë cilësie, si dhe të plotësohet dosja me dokumente përkatëse teknike ligjore

21. Gjetje. Në Bashkisë Memaliaj që prej datës 22.10.2013 nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Inspektoriat i Ndërtimor Urbanistik në kundërshtim me nenin 3, të ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar.

Rekomandim. Kryetari i Bashkisë Memaliaj të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik me specialistë të fushës përkatëse për disiplinimin e veprimtarisë në fushën e ndërtimit.

22. Gjetje. Për vitin 2013, Buxheti i Bashkisë është planifikuar në total 34,746,000 lekë dhe është realizuar rreth 22,417,000 lekë, ose në masën 64.5%. Për vitin 2014, është planifikuar në total 39,690,000 lekë, dhe është realizuar rreth 30,165,000 leke, ose në masën 76%. Për 6 mujorin e parë të vitit 2015, është planifikuar në total 17,380,00 lekë, dhe është realizuar si 5-mujor rreth 9,870,00 lekë, ose në masën 56.7%. Mos realizimi i buxheteve për të gjithë periudhën e mësipërme ka ardhur kryesisht, si pasojë e mos realizimit të të ardhurave nga tarifat dhe taksat vendore që paguhen nga popullata (familjarët), si tarifat e pastrimit, gjelbërimit, etj.

Rekomandim. Për të eliminuar shpenzimet e tepërta mbi detyrimin e konstatuar, duhet që Bashkia të negociojë me sipërmarrësin e pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit, për të lidhur një marrëveshje për ristrukturimin e këtij borxhi, duke e paguar atë në përpjesëtim të drejtë për çdo muaj.

23. Gjetje. Në datën 24.11.2014 është zhvilluar me mjete elektronike procedura e prokurimit për “Rikonstrukcionin i rrugës “Rrapo Çela”, i rrugës hyrëse qytet “Selam Musai”, “Memo Nexhipi”, “Tahir Gashi”, “Raship Brahimi”, me fond limit 39,238,712 lekë.

Operatori fitues ka paraqitur ofertë më të ulët ekonomikisht se operatori tjetër i kualifikuar dhe i shpallur fitues me diferencë të konsiderueshme prej 5,035,490 lekë me TVSH. Si pasojë e kësaj shkelje nuk është përmbushur qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” në lidhje me mirëpërdorimin e fondeve buxhetore, pasi nuk janë kursyer fonde buxhetore, duke i shkaktuar Buxhetit të Shtetit **efekte negative në vlerën 5,035,490 lekë me TVSH.**

Rekomandim. Në çdo procedurë prokurimi kërkesat e veçanta për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve të hartohen dhe përcaktohen në zbatim të rregullave të prokurimit publik dhe të argumentohen në raport dhe përpjesëtim të drejtë me vëllimin dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet.

24. Gjetje. Me VKM nr. 280, datë 12.03.2008 dhe VKM nr. 974, datë 30.09.2009 ka përfunduar procesi i transferimit të pronave të paluajtshme publike, pyjeve dhe kullotave të kësaj Bashkie. Sipas këtyre VKM-ve, janë transferuar gjithsej 266 prona shtetërore. Në përbërje të strukturës organizative të Bashkisë nuk është ngritur dhe nuk funksionon Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve. Mos ngritja dhe mos funksionimi i këtij sektori është në kundërshtim me VKM-në Nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme” dhe me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 të Ministrisë së Pushtetit Vendor e Decentralizimit.

Rekomandim. Në strukturën organizative të Bashkisë Memaliaj të ngrihet dhe të funksionojë Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në përputhje me VKM-në nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme”.

25. Gjetje. Në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, nuk ka filluar aplikimi dhe nuk është regjistruar pranë ZVRPP-së Gjirokastër asnjë pronë që i është transferuar kësaj Bashkie .

Rekomandim. Bashkia Memaliaj të fillojë aplikimin pranë ZVRPP-së, Gjirokastër për regjistrimin e pronave të transferuara.

26. Gjetje. Nisur nga mungesa e një strukture të posaçme për menaxhimin e pronave dhe nga vonesat e tej zgjatura të regjistrimit nga ZVRPP, Bashkia duhej të ngrinte grupe pune dhe të bashkëpunonte me institucionet që i kanë pasur këto prona në inventar për të bërë dhe për të mundësuar, mbledhjen e dokumentacionit me qëllim vlerësimin dhe inventarizimin paraprak dhe me pas regjistrimin në kontabilitetin e Bashkisë të pronave të transferuara, në zbatim të pikës 22, të VKM-se nr. 500 date 14.08.2001 “ Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” .

Rekomandim. Të ngrihen grupe pune për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm e të nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar ato, me qëllim vlerësimin paraprak të tyre dhe regjistrimet në kontabilitet, në përputhje me pikën 22, të VKM-së nr.500,datë 14.08.2001“Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje. Bashkia Memaliaj ka kryer pagesa më tepër në 12 raste në vlerën 79,868 lekë për shpenzime të konsumit të ujit në bazë të faturave të lëshuara nga Shoqëria e Ujësjellësit, të cilat janë faturuar në mënyrë të gabuar në kundërshtim me UMF nr 30 datë 27.12.2011” dhe dhe UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” .

Rekomandim. Bashkia Memaliaj të bëjë ndalesat për diferencë në faturat e ardhshme ose të kërkoet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **79,868 lekë**, të përfituar tepër për SHA Ujësjellës Tepelenë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

2. Gjetje. Në datën 24.11.2014 është zhvilluar me mjete elektronike procedura e prokurimit për “Rikonstruksioni i rrugës “Rrapo Çela”, i rrugës hyrëse qytet “Selam Musai”, ”Memo Nexhipi”, “Tahir Gashi”, ”Raship Brahimi”, me fond limit 39,238,712 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë. KVO, ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues operatorin “L.....N”, me ofertën

ekonomike në vlerën 32,173,740 lekë, si dhe ka s'kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë "B.....&B...-...IS" të cilët kanë paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 27,977,498 lekë, ose më të ulët se operatori fitues, me diferencë më pak në vlerën 4,196,242 lekë. S'kualifikimi i këtij operatori është bërë nga KVO për mos plotësim të disa kriterëve kualifikuese. Pra, vendosja e këtyre kriterëve është diskriminuese, sepse ato nuk sigurojnë barazi ndërmjet operatorëve ekonomikë, por shmangin konkurrencën, duke favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar. Ky veprim, përveç se është në shkelje të bazës ligjore të sipër cituar, është në kundërshtim edhe me nenin 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe është bërë shkak që KVO-ja gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të s'kualifikojë operatorin "B....&B....S", pikërisht për mos plotësim të këtyre kriterëve. Por, ky operator ka paraqitur ofertë më të ulët ekonomikisht se operatori tjetër i kualifikuar dhe i shpallur fitues me diferencë të konsiderueshme prej 5,035,490 lekë me TVSH. Si pasojë e kësaj shkelje, nuk është përmbushur qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" në lidhje me mirë përdorimin e fondeve buxhetore, pasi nuk janë kursyer fonde buxhetore, duke i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dëm ekonomik në vlerën **5,035,490 lekë me TVSH**.

Rekomandim 2. Të ndiqen të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për shpërbimin e dëmit ekonomik në vlerën **5,035,490 lekë** nga Anëtarët e Njësisë së Prokurimit: z. L.N, znj. O.Ç, z. D.P, dhe nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. L.M.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*" dhe nenin 59 "*Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore*" të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Memaliaj të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e trajtuara për secilin punonjës, të kërkojë fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore "**Vërejtje**" deri në "**Largim nga puna**", parashikuar nga neni 58 pika "ç" e ligjit nr. 152/2013 për:

1. Z. B.L., me detyrë nën/Kryetar i Bashkisë dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, për keto shkeljet e konstatuara:

- Për pagesa për periudhen objekt auditimi në 5 raste në vlerën 1,213,200 lekë për shërbimin e mirëmbajtjes së ndriçimit dhe ruajtjes së godinës së Bashkisë si dhe për trajnier ekipi futbollit në bazë akt-marrëveshjeve jo sipas formatit tip kontratës së shërbimit të përcaktuar në ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë" neni 420.

- Për pagesa pjesore në vlerën 4,474,013 lekë për 10 fatura në vlerën 7,735,629 lekë për shërbimin e pastrim-gjellbërimit, mirëmbajtjes së varrezave dhe dekorit, ku situacionet e tyre janë miratuar nga supervizori në mungesë të dokumentacionit të plotë të mbajtur për ndjekjen në mënyrë periodike mbi bazën e grafikut të shërbimeve për periudhen e situacionuar në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar Kreu VIII , pika 1/(d), Pika 2/a,b. "Mbikëqyrja e kontratës" dhe ligjit 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 40 dhe ligjit nr.8094 datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave" neni 14.

- Për pagesa të bëra në të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla për periudhen objekt auditimi në mungesë të kërkesës të argumentuar për përcaktimin e nevojave dhe në mungesë të akt të marrjes në dorëzim të mallrave apo punimeve në kundërshtim me Urdhrin MF nr. 92 datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë" tabela 1/3 i shfuqizuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33 datë 11.07.2013 "Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë" dhe UMF nr 30 datë 27.12.2011", rubrika "Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve" pika 37 dhe rubrika "Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara" pika 42,43 dhe 44.

- Për pagesat e kryera për shpenzime për blerje mallrash e shërbimesh në 35 raste në vlerën 2,612,854 lekë, ku u paraqitën mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumenteve justifikues, autorizues dhe vërtetues, mbështetës të pagesave si akt-konstatimet e problematikave për përcaktimin e nevojave për blerje, argumentimi i fondit limit si dhe faturat e blerjeve nuk janë të rregullta sipas formatit të thjeshtë tatimor, fatura të pa plotësuara konform dokumentit të plotë financiar, si dhe nuk janë firmosur nga anëtarët e komisionit në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/26, neni 9/ë, neni 12/e, f, neni 13.

- Për pagesa të kryera më tepër në 12 raste në vlerën 79,868 lekë për shpenzime të konsumit të ujit në bazë të faturave të lëshuara nga Shoqëria e Ujësjellësit, të cilat janë faturuar në mënyrë të gabuar në kundërshtim me UMF nr 30 datë 27.12.2011” dhe UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit.”

- Për pagesa “Mbeturinat” të Ligjit nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, me një efekt negativ për buxhetin e Bashkisë në shumën 247,767 lekë.

- Në situacionet për shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra, janë situacionuar në të njëjtën vlerë dhe sasi punimi për çdo muaj dhe paguar zëri “Mirëmbajtje stolash” në vlerën 35,065 lekë ose në situacionet e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave është situacionuar zëri “Mirëmbajtje muri rrethues” në vlerën 37,312 lekë, zëra për të cilat nuk ka çfarë punimesh të kryhen çdo muaj.

- Për shpenzimet e kryera për riparime apo blerje materialesh, të cilat janë situacionuar në zëra të veçantë punimesh, duke përmendur këtu edhe për shërbimin e “Dekorit”, nuk janë shoqëruar dhe nuk janë kërkuar nga mbikqyrësit dokumentacion për kryerjen e këtyre shpenzimeve.

- Për mungesë të bashkëveprimit për hartimin e një plani të veprimeve, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik si dhe hartimin e rregullores së brendshme të funksionimit të të kësaj njësie vendore.

- Me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit “Rikonstruksioni i rrugës “Rrapo Çela”, i rrugës hyrëse qytet “Selam Musai”, “Memo Nexhipi”, “Tahir Gashi”, “Raship Brahimi”, me fond limit 39,238,712 lekë, të realizuara në vitin 2014, nuk ka marrë në konsideratë kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi nuk i ka kërkuar bashkimit të operatoreve ekonomikë “B...&B....S” sqarime për devijimet e vogla të vërejtura në ofertën teknike të tij.

2. **Z. Vasil Polo,** me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

3. **Z. Ergest Hysesani,** me cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

4. **Z. Lefter Ndrijo,** me cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit,

5. **Znj. Oniada Çibuku,** me cilësinë anëtares së Njesisë së Prokurimit,

6. **Z. Drini Pasho,** me cilësinë Anëtares të Njesisë së Prokurimit në procedurat e prokurimit “Rikonstruksioni i rrugës “Rrapo Çela”, i rrugës hyrëse qytet “Selam Musai”, “Memo Nexhipi”, “Tahir Gashi”, “Raship Brahimi”, me fond limit 39,238,712 lekë, të realizuara në vitin 2014, nuk ka marrë në konsideratë kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi nuk i ka kërkuar bashkimit të operatoreve ekonomikë “B....S” sqarime për devijimet e vogla të vërejtura në ofertën teknike të tij. Pasoja e kësaj shkelje i ka shkaktuar buxhetit të shtetit **dëmin ekonomik në vlerën 5,035,490 lekë.**

Nga Bashkia Memaliaj, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në process vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Xhovan Domi, Irma Shkupi, Vasil Vane, Skënder Muça, Marvin Karalli, Bashkim Arizaj, Koço Sokoli dhe Aleksandër Papadhimetri, më tej u shqyrtua nga

z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Grupi i Auditimit

Xhovan	DOMI
Irma	SHKUPI
Vasil	VANE
Skënder	MUCA
Marvin	KARALLI
Bashkim	ARIZAJ
Koço	SOKOLI
Aleksandër	PAPADHIMITRI